REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER GJERGJ R. KONGOLI**
**ADRESA NJESIA ADMINSITRATIVE NR. 10, RR. KONT URANI, GODINA NR. 3**
**TEL: 0682033057**

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 2647** **Nr. koleksioni: 703**

**Tirane më 26/06/2020**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2020053630040137555

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë

A2020053630040137555

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI**
*( TË SHOQËRISË "NTPS" SH.P.K)*

Sot, më datë 26.06.2020, para meje Noter GJERGJ R. KONGOLI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINSITRATIVE NR. 10, RR. KONT URANI, GODINA NR. 3 , u paraqit personalisht:

**PALET**

**Jorge Jeha, shtetas Brazilian, lindur ne Belo Horizonte, ne date 15.06.1953 dhe banues ne Tirane,mbajtes i pasaportes Braziliane nr. YC067092, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, njohes i gjuhes angleze, i cili ne baze te Ligjit 110 date 20.12.2018 pranoi t'i lexohet ky akt ne gjuhen Anhleze ne prani te Perkthyeses Mimoza Ali Backa.**

dhe

**Ilir Shtufi,** shtetas shqiptar, atesia Xhemal, lindur ne Tirane, me date 13.10.1973dhe banues ne Tirane mbajtes i kartes se identitetit me nr. Personal H31013090C, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar(ne kete kontrate referuar si **"Bleresi");**

**MEQENESE**

A. Shitësi është ortak i vetëm i shoqërisë **"NTSP" Shpk**, nje shoqëri me përgjegjësi te kufizuar regjistruar me date 25.01.2018 pranë Qendrës Kombëtare te Regjistrimit me numër identifikimi NUIS L86326601H (ketu e me poshtë e quajtur **"NTSP"Shpk** kapitali i te cilës është 100,000 Leke(njëqind mije).
B. Shitësi zotëron perkatesisht**100% t**e aksioneve e konvertuar ne vlere kapitali 100,000 Leke, e konvertuar ne 1 kuote tek shoqeria **"NTSP"Shpk.**
C. Shitësi dëshiron te shesë tek Bleresi Z. Ilir Shtufi, 1 pjese te kuotes ne masen prej 45% qe zoteron tek shoqeria**"NTSP"Shpk.**

**PER SA ME SIPER**, duke marre parasysh marrëveshjet reciproke te permbajtura ne kete akt, palët bien dakord per sa vijon:

**NENI 1**
**OBJEKTI I KONTRATES**

Ortaku i vetëm i shoqërisë me vendimin Nr. 5 Prot, date 26/06/2020 bazuar ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit te Shoqërisë, ka vendosur ne te tjera:

- Transferimin nëpërmjet Shitjes te 45% te kapitalit te zotëruar nga ortaku Z. Jorge Jaha te Z. Ilir Shtufi identifikuar me karte identitetit me nr. Personal H31013090C.

**NENI 2**
**BLERJA DHE SHITJA E KUOTAVE**

Sipas dispozitave te kësaj Kontrate, **Shitësi** nëpërmjet këtij akti shet dhe **Bleresi** blen kuotën qe zotëron tek shoqëria **"NTSP"Shpk**, qe përfaqëson 45 % te kapitalit te shoqërisë **"NTSP"Shpk** me vlere 45,000 Leke(dyzet e pese).
Kjo kuote blihet me çmimin e përcaktuar ne nenin 3 te kesaj Kontrate

**NENI 3**
**ÇMIMI I BLERJES DHE MENYRA E PAGESES**

3.1. Çmimi i blerjes se kuotës objekt i kesaj Kontrate eshte ne vleren prej 45,000 Leke, me poshtë i quajtur "Çmimi i Blerjes".
Blerësi Z. Ilir Shtufi, ka paguar plotesisht cmimin e shitjes ne favore te Z. Jorge Jeha dhe shtiesi deklaron se ka marre çmimin e plote te shitjes dhe nuk ka asnje pretendim.

3.2. Referuar ligjit 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9901, date 14.4.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar" dhe konkretisht nenit 10 ku thuhet se "Ne rastet e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuoten, si dhe kushtet e tjera te kalimit, perfshire momentin e pageses se çmimit, rregullohen nga kontrata", palet jane dakord qe:
Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Bleresi, pra Z. Ilir Shtufi menjehere perfiton pronesine mbi Kuoten me vlere prej 45,000 Leke te shoqerise **"NTSP"Shpk**

**NENI 4**
**DEKLARATAT DHE GARANCITE**

4.1. Shitësi deklaron dhe garanton se:
(i) nenshkrimi dhe zbatimi e kësaj kontrate është autorizuar rregullisht
(ii) kjo kuote qe transferoheteshte e lire nga çdo barre apo ndonje pretendim tjeter ligjor nga pale te treta,
(iii) kjo Kontrate përben një detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe te ekzekutueshëm per Shitesin.

4.2. Bleresi deklaron dhe garanton se:
(i) nenshkrimi dhe zbatimi i kesaj Kontrate eshte autorizuar rregullisht
(ii) ka te drejten, dhe nuk ka ndonje ndalim ligjor apo te ndonje lloji tjeter, per te nenshkruar dhe zbatuar kete Kontrate dhe detyrimet qe rrjedhin prej saj;
(iii) kjo Kontrate eshte neshkruar rregullisht dhe perben nje detyrim ligjor, te vlefshem dhe te detyrueshem per Bleresin.

**NENI 5**
**TE NDRYSHME**

Pas realizimit te ketij transferimi me neshkrimin e kesaj kontrate, Bleresi Z. Ilir Shtufi behet pronar i ligjshem i 45% te kuotave objekt kontrate, ndersa Shitesi Z. Jorge Jeha zhvishet teresisht nga e drejta e

A2020053630040137555

pronesise mbi keto kuota dhe mbetet pronar i 55% te kuotave te shoqerise "NTSP" Shpk

**NENI 6**
**LIGJI I ZBATUESHEM DHE MOSMARREVESHJET**

6.1. Problemet ne lidhje me çeshtje qe mund te lindin sipas kesaj Kontrate por qe nuk jane parashikuar ne te, do te zgjidhen ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise, te cilet do te jene te zbatueshme ne kete Kontrate.

6.2. Çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis paleve ketu ne lidhje me kete Kontrate dhe qe nuk do te zgjidhet nga negociatat midis tyre, do te jete objekt vendimi te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kjo kontrate, nenshkruhet ne 4 kopje ne gjuhen shqipe me vlera te njejta juridike dhe palet deklaruan se jane dakort me sa me siper dhe pasi e lexuan, e kuptuan, e neshkruan regullisht perpara meje dhe une noteri, e vertetoje ate sipas ligjit.

**SHITESI**
**JORGE JEHA**

**BLERESI**
**ILIR SHTUFI**

**PERKTHEU**
**MIMOZA BACKA**

MIMOZA BACKA
Perkthyese e Betuar / Sworn Translator
Cel. +355/6[illegible]4621
Rr. Budi Nr. 8 Tiranë - ALBANIA

NOTER
GJERGJ KONGOLI

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-20200625155425172 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 25.06.2020 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 3:54:25PM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-585-4000 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

NTSP SH.P.K.

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANË - ALBANIA